Doktrina e Besëlidhje 77–80
12–18 KORRIK

# Thirrur nga Zoti

Ashtu si Xhered Karteri dhe Stivën Bërneti (shih Doktrina e Besëlidhje 79 dhe 80), misionarët në ditët e sotme gjithashtu kanë nevojë për një dëshmi që ata thirren nga Zoti.

Mijëra misionarëve iu ndryshuan thirrjet për mision për shkak të virusit korona. Për shembull, Kërtis dhe Ramona Milleri u ricaktuan në një mision tjetër për shkak të virusit. Ata dëshmuan: “Ne kemi një dëshmi të fortë se nuk ka rëndësi se ku shërbejmë, por që jemi të gatshëm të shërbejmë. Ndërsa e lejojmë dorën e Shpëtimtarit të na drejtojë në jetën tonë, Ai na kualifikon për këtë punë.”

## XHERED KARTERI (1801–1849)



- U pagëzua nga Hajrëm Smithi në vitin 1831 në Kollsvill të Nju-Jorkut.



- Predikoi në Ohajo, Pensilvani, Nju-Jork dhe Vermont në vitin 1831 dhe 1832.
- Shkoi në Hajrëm, Ohajo për të pyetur Jozef Smithin se cili ishte vullneti i Zotit për të.
- Jozef Smithi mori një zbulesë që e drejtoi të predikonte sërish në lindje të Shteteve të Bashkuara (shih Doktrina e Besëlidhje 79).



## STIVËN BËRNETI (1813–1885)



- U pagëzua nga Xhon Murdoku në vitin 1830 në Uorrensvill të Ohajos.



- U shugurua prift i lartë në moshën 17-vjeçare.
- U caktua për të predikuar bashkë me Eden Smithin (shih Doktrina e Besëlidhje 80:2), por Edeni u sëmur.



- Filloi misionin e tij me babanë e Edenit, Xhon Smithin.



## KËRTIS DHE RAMONA MILLERI

- Duke parë mundësitë në faqen e internetit të Kishës për misionarët në moshë, çifti Miller përzgjodhi tetë vendndodhje të mundshme – shumica e të cilave ishin në Polinezi dhe Europë.
- U erdhi thirrja për të shërbyer në Republikën Demokratike të Kongos.






- Do t’u duhej të mësonin frëngjisht.
- Pas tre muajsh e gjysmë në Afrikë, çifti Miller u ricaktua që të shërbente në Xhorxhia të SHBA-së për shkak të COVID-19.




ILUSTRIMET NGA BRYAN BEACH